

Emri i Lëndës : E Drejte Ndërkombëtare Publike II

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 302	B	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00

Lektori	Denard Veshi, Prof. Assoc. Dr.
Asistenti	Gentjan Skara, PhD
Gjuha e kursit	Shqip
Niveli i lëndës	Program i Integruar
Përshkrimi	Lënda është i konceptuar si i përbërë prej disa pjesëve, të cilat ofrojnë njohuri për sa i përket instituteve kryesore të së Drejtës Ndërkombëtare të Detit, të së Drejtës Ndërkombëtare të Traktateve, të së Drejtës Diplomatike dhe Konsullore, të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, etj. Vëmendje e veçantë u kushtohet mekanizmave ndërkombëtarë për zgjidhjen paqësore të konflikteve ndërkombëtare.
Objektivat	Objektivi kryesor i studimit të lëndës E Drejta Ndërkombëtare Publike II është t'u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme mbi Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike 1961 dhe rëndësinë e saj; Konventën e detit 1982 UNCLOS II, organizimit të Kombeve të Bashkuara dhe rolin dhe kompetencat e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Vëmendje e veçantë u kushtohet mekanizmave ndërkombëtarë për zgjidhjen paqësore të konflikteve ndërkombëtare.
Konceptet Kryesore	1. Imunitetet e diplomatëve 2. Mision diplomatik 3. Diplomati 4. Konsull 5. Ujra territoriale 6. Zona Ekonomike Ekskluzive 7. Shelfi kontinental 8. Deti i hapur 9. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë 10. Arbitrazhi 11. E drejta humanitare 12. Ndërmjetësimi

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike 1961 Ky leksion trajton zhvillimin historik të së drejtës diplomatike dhe materializimin e saj nëpërmjet Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike 1961. Leksioni trajton rëndësinë e Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike 1961 dhe identifikon normat zakonore të cilat janë materializuar në Konvent. Gjithashtu leksioni trajton edhe rëndësinë që kjo Konventë ka në ditët e sotme. Literatura përkatëse: 1. Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 750-752 2. Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike 1961
2	Misionet diplomatike, marrëdhëniet konsullore, misionet e veçanta, misione të përhershme nga organizatat ndërkombëtare Kjo temë trajton mënyrën organizative të misioneve diplomatike dhe konsullore. Studentët do të njihen me nenet kryesore të Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike 1961 dhe gjithashtu do të analizojmë edhe legjislacionin shqiptar që rregullon misionet diplomatike dhe konsullore. Literatura përkatëse: 1. Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 752-752. 2. Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike 1961.
3	Funksionet e misionit diplomatik, përfaqësuesit diplomatik, imunitetet dhe privilegjet diplomatike Kjo temë trajton funksionet e misionit diplomatik, përfaqësuesit diplomatik, imunitetet dhe privilegjet diplomatike. Do të analizohet se çfarë kompetencash parashikon Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike 1961 lidhur me ndërhyrjet e diplomateve në punët e brendshme të shteteve pritëse. Gjithashtu, tema do të trajtojë edhe imunitetin civil dhe penal që gezon diplomati. Literatura përkatëse: 1. Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 752-772 2. Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike 1961

4	Misionet e përhershme në organizatat ndërkombëtare. Punonjësit e organizatave ndërkombëtare Ky leksion do të trajtojë misionet e përhershme në organizatat ndërkombëtare. Studentët do të njihen me imunitetin dhe privilegjet që gëzojnë personat për të ushtruar funksionet e tyre. Gjatë leksionit disa raste nga praktika ndërkombëtare do të diskutohet. Literatura përkatëse: 1. Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 772-777.
5	E drejta e detit: Konventat dhe rendesia Kjo temë trajton të drejtën e detit. Së pari do të shpjegohet zhvillimi historik i së drejtës së detit duke iu referuar autorit të shquar Hugo Grotius. Me pas do të trajtohet konventat kryesore dhe rëndësia e tyre. Gjatë trajtimit të leksionit, një theks të vecantë do t'iu kushtohet normave zakonore të materializuara në konventa. Literatura përkatëse: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 283-287. 2. Malcolm Shae, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 553-556. 3. Konventa e vitit 1982 për të Drejtën e Detit
6	Ujrat territoriale dhe ZEE: të drejtat dhe detyrimet Kjo temë trajton të drejtat dhe detyrimet e shtetit në ujrat territorial dhe Zonën Ekonomike Ekskluzive. Këto dy zona paraqesin një rëndësi të madhe pasi përcaktojnë sovranitetin e shtetit. Sipas konventës UNCLOS III ujëra territoriale të një shteti shtrihen deri në 12 milje detare tej nga vija bazë dhe shteti është i lirë të vendosë ligje, të rregullojë përdorimin dhe të përdorë çdo burim. Gjithashtu, Konventa UNCLOS III parashikon kalimin paqësor të anijeve. Edhe Zona Ekonomike Ekskluzive paraqet një rëndësi pasi shteti ka të drejtë të shfrytëzojë të gjitha burimet natyrore. Kjo zonë u vendos pikërisht për të zgjidhur përplasjet e nxehta mes shteteve për shfrytëzimin e burimeve natyrore, veçanërisht naftës. Literatura përkatëse: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 287-296. 2. Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 556-584 3. Konventa e vitit 1982 për të Drejtën e Detit
7	Shelfi kontinental dhe Deti hapur Kjo temë trajton të drejtat dhe detyrimet e shtetit në shelfin kontinental dhe të detit të hapur. Pjesa e territorit të një shteti, të zgjatur nën ujë, duke filluar nga Vija Bregdetare ose Vija Bazë e tij dhe duke vijuar drejt detit dhe thellësia e ujërave të tij është, përafërsisht 100 deri 200 metra dhe quhet "Shelf Kontinental". Çështja e vendosjes së shtrirjes së Shelfit Kontinental midis shteteve që lagen nga dete ka përbërë dhe përbën, aktualisht problemin më të madh dhe sfidën më të madhe për t'u zgjidhur. Arsyeja është se në shelfet (zonat me thellësi 100-200m) janë zbuluar rezerva të mëdha naftë dhe gazi si në Detin Mesdhe, Kinë-Kore-Japoni-Taivan-Vietnam dhe kohët e fundit, edhe në Detin e Zi. Gjithashtu, në këtë leksion do të trajtohet edhe deti i hapur i cili është edhe për shtetet që nuk kanë dalje në det. Shtetet që nuk kanë dalje në det, mund të ushtrojnë këte të drejtë nëpërmjet marrëveshjeve që lidhin me shtetet me të afërta që kanë dalje në det, të cilat në raste të tilla u njohin shteteve pale të drejtën e kalimit tranzit nëpër territorin e tyre, si dhe të drejtën për të përdorur portet që ata u venë në dispozicion. Anijet tregtare dhe anijet e luftës bashkë me ekuipazhet e tyre, në kohën që ndodhen në det të hapur, u nënshtrohen vetëm ligjeve të vendit, flamurin e të cilit ato mbajnë. Flamuri është shenja që tregon shtetësinë e anijes. Nga parimi i barazisë sovraane i të gjitha shteteve del edhe parimi i barazisë se të gjithë flamureve në det të hapur Literatura përkatëse: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 296-312. 2. Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 584-628 3. Konventa e vitit 1982 për të Drejtën e Detit
8	Provimi Gjysmë - final
9	E drejta Ndërkombëtare e Mjedisit Kjo temë trajton të drejtën ndërkombëtare të mjedisit. Gjatë leksionit do të trajtohet kuadri ligjor ndërkombëtar dhe do të diskutohet lidhur me problemet më kryesore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, leksioni do të trajtojë edhe diskutimet më të fundit në këtë fushë. Literatura përkatëse: 1. Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 844-901.
10	E drejta ndërkombëtare humanitare Në këtë temë do të trajtohet E drejta ndërkombëtare humanitare (DNIH) e cila është një grup rregullash për arsye humanitare, qëllimi për të kufizuar pasojat e konflikteve të armatosura. DNIH mbron ata të cilët nuk kanë ose nuk marrin pjesë në armiqësi dhe kufizon mjeteve dhe metodave të luftimit. DNIH është pjesë e së drejtës ndërkombëtare, që në fakt rregullon marrëdhëniet ndërmjet shteteve. E drejta ndërkombëtare është implementuar nëpërmjet marrëveshjeve midis Shteteve - traktateve apo konventave, nëpërmjet rregullave zakonore të cilat janë të bazuara në praktikën e suksesshme të këtyre vendeve për të futur rregulla si ligjërisht të detyrueshme, por edhe nga parimet bazë. DNIH aplikohet gjatë konflikteve të armatosura. Megjithatë, DNIH nuk e rregullon situatën, kur një shtet mund të përdor forcën: ai është i qeverisur nga një pjesë e rëndësishme, por në mënyrë të qartë distinktionin së drejtës ndërkombëtare, e cila është e përfshira në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Gjatë leksionit, do të trajtohet origjina, natyra dhe kodifikimi i DNIH. Gjithashtu do të diskutohet nëse DNIH aplikohet në praktikë apo jo. Literatura përkatëse: 1. Malcolm Shaw, International law (6 ed, Cambridge University Press 2008) 1167-1203.

11	Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe roli në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare Në këtë javë do të trajtohet OKB. Do të diskutohet mbi zhvillimin historik OKB dhe strukturën organizative. Një rol të vecantë do ti kushtohet rolit të OKBsë në zhvillimin dhe kodifikimin e së drejtës ndërkombëtare. Komisioni Ndërkombëtar i së Drejtës do të analizohet dhe do të diskutohet mbi punën e tij. Literatura përkatëse: 1. Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 1204-1281.
12	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë Kjo temë trajton Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë që është një gjykatë e përhershme e OKB-së me seli në Hagë. Ajo e ka filluar punën në vitin 1946, kur zëvendësoi Gjykatën e Përhershme Ndërkombëtare të Drejtësisë që kishte funksionuar që nga viti 1922. Gjatë leksionit do të trajtohet struktura e GJND; funksionet; kompencat; subjektet që mund ti drejtohen dhe natyra e vendime apo këshillave të Gjykatës. Në fund do të diskutohet nëse vendimet e GJNDsë kanë qenë të sukseshme. Literatura përkatëse: 1. Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) 1057-1117.
13	Zgjidhja e konflikteve në menyrë paqësore I Në përputhje me nenin 2(3) të Statuti të OKBsë të gjithë anëtarët 'do ti rregullojnë mosmarrëveshjet e tyre ndërkombëtare me mjete paqësore, në mënyrë që të mos rezikohet paqja, siguria dhe drejtësia ndërkombëtare'. Në këtë leksion do të diskutohet rreth metodave kryesore efikase për zgjidhjen e konflikteve sic janë: ndërhyrja e një pale të tretë, grupet e synuara, negociatat, arbitrazhi, ndërmjetësimi. Këto metoda janë konsideruar funksionale në varësi të qasjes së palëve të përfshira në konflikt, ashtu edhe të atyre të përfshira në zgjidhjen e konflikteve. Literatura përkatëse: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 363-403.
14	Zgjidhja e konflikteve në menyrë paqësore II: Raste Studimore Pas analizës teorike, studentët do të analizojnë një rast studimor. Trajtimi objektiv i rasteve të konflikteve në botë të cilat paraqesin objekt studimi përbën mundësi për analizimin e fazave të zhvillimit të këtyre konflikteve, rolin e palëve të përfshira në konflikt, metodave etj. Rasti i konfliktit të Kosovës, përbën model të ilustrimit se si një konflikt i ashtuquajtur nga njëra palë në konflikt si: "çështje e brendshme" mund të marrë përmasa jo vetëm rajonale të përfshirjes së palëve tjera në pasojat e konfliktit, por edhe globale në përfshirjen e akterëve të ndryshëm në zgjidhjen e tij. Literatura përkatëse: 1. Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) 363-403.
15	Përsëritje
16	Provimi Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • Martin Dixon, E Drejta Ndërkombëtare (AIIS 2010) • Malcolm Shaw, International law (6 edition, Cambridge University Press 2008) • Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike 1961 • Konventa e vitit 1982 për të Drejtën e Detit	
Referenca të tjera	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të kenë përvetësuar njohuri të përgjithshme mbi të Drejtën Ndërkombëtare Publike dhe zbatimin praktik të normave të saj në fushën e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore
2	Pas përfundimit me sukses të këtij kursi, studentët janë në gjendje të dallojnë format e veçanta të institucioneve që përfaqësojnë shtetet dhe organizatat ndërkombëtare në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella;
3	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mund të identifikojnë dhe të zbatojnë parimet ndërkombëtare ligjore në të drejtën e detit, të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe atë të mjedisit.
4	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të mund të marrin informacion lidhur me organizimin dhe kompetencat e GJNDsë, si dhe problemet e hasura në zbatimin e vendimeve.
5	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të zhvillojnë shkathtësi komunikimi, në të shkruar dhe përmes prezantimeve verbale
6	Lënda do të përgatisë studentët për një karrierë në organizatat ndërkombëtare me trajnimin e tyre në strukturën dhe kompetencat e organizatave ndërkombëtare institucionale.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	20	20
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			148
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.92
ECTS			6.00